



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT**

THIRRJE

**PËR “SHPREHJE INTERESI PËR EKSPERTË TË KOMISIONEVE TË VLERËSIMIT
TEKNIK TË PROJEKTEVE NË AGJENCINË KOMBËTARE TË KËRKIMIT
SHKENCOR DHE INOVACIONIT (AKKSHI)”**

Në zbatim të ligjit Nr. 80, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Vendimit Nr.607, datë 31.08.2016, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI) dhe të Vendimit Nr. 567, datë 23.10.1995, të Këshillit të Ministrave “Për shpërblimin e Këshillave, Komisioneve dhe Ekspertizave të Veprimtarisë Shkencore e Teknologjike”, AKKSHI shpall thirrjen për aplikim për ekspertë të Komisioneve të Vlerësimit të projekteve sipas fushave të mëposhtme:

- Biodiversiteti dhe Mjedisi
- Bujqësia, Ushqimi dhe Bioteknologjia
- Sistemet dhe Teknologjitë e Informacionit
- Shëndetësia dhe Shkencat Mjekësore
- Shkencat Sociale dhe Albanologjike
- Uji dhe Energjia

Kriteret për aplikim

Aplikantët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

1. Të kenë gradën shkencore “Doktor” në fushën përkatëse apo të ngjashme me të.
2. Të kenë përvojë në kërkim shkencor dhe projekte të kërkimit shkencor.
3. Zotërimi i titujve akademikë përbën përparësi.
4. Aplikantë të cilët nuk janë në konflikt interesi të përcaktuar si i tillë në legjislacionin përkatës në fuqi.
5. Të kenë njohuri të mira të gjuhës angleze.
6. Të jenë nga institucionet e mëposhtme:
 - a) IAL
 - b) ASH
 - c) Kërkues nga diaspora
 - d) Shoqëri Civile

- e) Institucione të qeverisjes qendrore dhe vendore
- f) Qendra te Transferimit të Teknologjive Bujqësore
- g) Të tjera që kanë në fokus të veprimtarisë kërkimin shkencor

Dokumentacioni për aplikim

Aplikantët duhet të dorëzojnë në AKKSHI dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Letër shprehje interesi lidhur me motivimin dhe ekspertizën që ofron si kërkues shkencor, pjesëmarrës në projekte apo dhe vlerësues projektsh.
2. Curriculum Vitae në shqip (formati Europass).
3. Kopje të diplomës së gradës shkencore/titullit akademik që zotëron.
4. Kopje të kartës së identitetit.

Adresa ku do të dërgohet aplikimi

Aplikantët duhet ta dorëzojnë dokumentacionin përmes adresës elektronike të AKKSHI-së: info@nasri.gov.al

Afati i aplikimit

Afati përfundimtar i dorëzimit të dokumentacionit të aplikimit është **data 31.01.2025.**

Informacion shtesë

Aplikantët e shpallur fitues si Ekspertë të Komisioneve të Vlerësimit nuk mund të jenë pjesë e grupeve të projekteve të kërkimit që vlerësohen në AKKSHI.

Ekspertët e Komisioneve të Vlerësimit të AKKSHI paguhën sipas dispozitave të Vendimit Nr. 567, datë 23.10.1995, “Për shpërblimin e Këshillave, Komisioneve dhe Ekspertizave të Veprimtarisë Shkencore e Teknologjike”.